



Zambaku i Gjakovës



Sabahate Byçi

P o e z i

Tiranë, 2009

Redaktor: Besim R CENGU

Reçenca: Ymer DOMI

Korektor: Ferit Dida

Paraqitja grafike: Ornela Bita

© Të drerjtat e rezervuara

ISBN: 978-99956-33-79-0

Shtëpia botuese: Geer

Tiranë, 2009

Brenga e mallit dhe e jetës në një vëllim poetik

Pasi lexon këto krijime, menjëherë një njohës i vargut poetik, por edhe dashamirës i letërsisë, arrin në përfundimin se kemi të bëjnë me një poete që e ka lëvruar poezinë me kohë dhe që di të kapë tema që i interesojnë jo vetëm artistit që i shkruan ato, por edhe të tjerëve që i lexojnë e i shijojnë.

Tematika e krijimeve poetike është me të vërtetë mbresëlënëse. Pas leximit të faqes së fundit të këtij vëllimi, ndjehen qartë gjurmët që lë çdo poezi në ndërgjegje të lexuesit. Përmes penelatave të holla dhe përzgjedhjes së fjalës, poetja ka aftësinë që të ftojë e të fusë brenda botës së saj, të bën për vete me mendimin e vet drejtpërdrejt pa vështirësi.

Nga ana tjetër këtë e them, se edhe pse këto poezi, i shkruan një shpirt i ndjeshëm njeriu që jeton larg vendit ku ka lindur dhe që (për fatin e mirë) nuk ka rënë në pellgun e nostalgjisë që shpesh herë bien duke u kapur “mat” krijuesit e larguar nga vendlindja për shkaqe kërkimit të një jete më të mirë diku tjetër.

Trajtesa tematike e poezisë është e larmishme dhe ka një fokus të gjerë gjykimi, sepse ky është edhe qëllimi i autores, që për mendimin tim ia ka arritur.

Kësisoj ne gjejmë vërtet krijime “nostalgjike” krejt të logjikshme, por nga ana tjetër hasim në poezi që kanë për qëllim trajtimin e jetën në përgjithësi, dritëhijet e saj, brengat e vështirësitë për ta përballuar, sfidat për të cilat njeriu është i detyruar t’i tejkalojë, pamëshirshmërinë që paraqet ajo për “njerëz të pambrojtur”, siç janë në të vërtetë mërgimtarët që lenë ëndrrat të prera në mes na vendin e tyre dhe nisin të detyruar një jetë të re që në të shumtën e rasteve nuk është e plotë, nuk përmbush aspiratat e qëllimet e jetës ku në fund të fundit, kur je në tokën tënde, jeton me njerëzit e tu të dashur dhe ke të njejtin mentalitet e kulturë me ta.

Në vendin e huaj nuk u jepen kushtet optimale të jenë si në vendin e tyre, ndaj as poetja dhe asnjë i mërguar tjetër kudoqoftë nuk është e mundur të përshtatet plotësisht me jetën, kulturën, traditat, gjuhën e shpirtin e njerëzve që gjen atje. Kuptohet se kjo jetë e mërgimtarit, sado që ka nivel më të lartë ekonomik, nuk u dhuron atyre (veçanarisht krijuesve) kënaqësinë, emocionin, relaksin e kondicionin e nevojshëm shpirtëror... Me një fjalë nuk u fal plotësisht të drejtën universale për të dashuruar, për t’u përpjekur, për të thënë pa ndrojtje fjalën, për të gjykuar njëlloj si të tjerët, për të kërkuar në brendësinë e jetës lumturinë e kuptimin e plotë të jetës...

Poezia ka brenda mallin, nostalgjinë për ikjen e rinisë, dashurinë për nënën, babain, vëllain, të dashurin...

Poezia e Sabahate Bycit ka një tematikë dhe një trajtim të atij lloji që e bën vargun të veçantë, teknikisht të një natyre tjetër, krejt tjetër, krahasuar me prodhimet e sotme poetike në vendin tonë. Ajo nuk pretendon shumë të shprehet përmes vargut, se sa përmes ndjenjës, përmes fjalës së përmallshme që ngjit e lë gjurmë, të bën të mendosh. Kjo ka bërë që poezia e këtij vëllimi është lehtësisht e kuptueshme, nuk ka ndërlikime të vargut e rëndesë të fjalës.

Së pari, poezia e Sabahate Bycit është qiellore në një farë mase, se ajo përmes poezisë së saj kërkon shpesh herë ndihmën e Hënës e Diellit, Qiellit etj. Kjo vërtetohet se gjatë udhëtimit poetik, poetja herë i “zgjat dorën Hënës”, herë “fshihet pas Diellit”, në një rast tjetër “fle me Hënën” duke kaluar kështu një natë ekzotike dhe pas kësaj “ik në pakthim...”.

Së dyti, poezia është edhe tokësore kur flet me dashuri për nënën e birin, babain, të afërmit, për kohën e nusërisë që ka ikur, për Shqipërinë, Gjakovën, Kukësin e Prishtinën, për jetën e vet personale dhe tallazet e kësaj jete që në disa raste e kanë përplasë në brigje të vështira, por që me guxim ajo i përballon.

Kjo gjetje artistike dhe këto mjete kanë realizuar qëllimin e një ndërtimi poetik që na bën ta quajmë vërtet interesant vëllimin, me varg që përbëhet prej fjalëve të kursyera dhe të zgjedhura, me ngarkesë emocionale e pa mbulesë të mendimit që rreket t’ia përcjellë lexuesit.

Në fund të fundit kjo është poezia; fjala cilësore, e përzgjedhur, ideja e qartë e mendimi i ngjeshur intensiv në varg, që dallon nga ligjërimi i përditshëm.

Krijimet poetike të këtij vëllimi janë fryt i një zemre shqiptare që pulson shqip, emocionohet shqip, dashuron e urren shqip, janë ide që dalin nga një mendje që mendon shqip, gjykon e analizon shqip, por edhe që mundohet t’u jepet të tjerëve nëpërmjet një poezie duke thirrë në ndihmë fjalën krenare, të bukur e kumbuese shqipe.

Besim R. Cengu -Tiranë, gusht 2009

* * *

VENDI BOSH NË SOFËR

Një gur,
Një bjeshkë,
Një mall...

Përtej malesh,
Dielli qet syrin,
Zemra qan...

Ika që të kthehem,
Por s'u ktheva ende,
Sepse ika nga vetvetja...

Nënë,
Më fal,
Për vendin,
Bosh në sofër...

Godonë kurrë nuk e kam dashur...

I

MË KA MARRË MALLI PËR SHQIPËRINË

Shqipëri,
Sa herë më merr malli për Ty
Ulem e qaj me lotë Kosove - Shqip
Na ka nëna Zemër tha:
- O nënë,
Këto janë lotët e Shqipes!

Lotët e maleve të Naimit
Të Lulit të vocërr
Lot - Debat - i kureshtjes
Sygjesti pa sarkazëm
- Ah, Bre!
“Sikur të isha djalë!”

Shqipëria ime!
Sa herë më merr malli për Ty
Qaj me lotë Kosove - Shqip
E në mend më bie fjala:
na ka - Nëna Zemër tha:
- O nënë,
- Ne jemi SHQIPËRIA E MADHE
Vetë!

MIRË U PAFSHIM

Nëse zbret nga Qabrati,
Ma përqafo Gjakovën,
Si të duash Ti.

Nëse vjen nga Tirana,
Eja ma merr mallin,
Bashkë me lotin e gëzimit.

Nëse kthehesh nga Prishtina,
Ma përqafo Gjakovën,
Si nëna me Babanë.

E nëse nga lindja e Diellit,
Në mbrëmje të shkon mendja,
Te Hëna,
Mos harro dhe dije,
Se unë me mallin e pashkruar,
Gjithnjë përqafoj Gjakovën,
Kosovën,
Timin Kukësin,
Tiranën,
Të tërën
TË MADHEN,
SHQIPËRINË.

TI VETË E DI

Përtej malesh Dielli e ngroh ditën,
“Moi”, atë, kur unë Ty dua të të harroj.

Përtej lumejsh, shiu përplaset e vërtitet
Në lagështinë e liqenit të kaltër - si sytë tu.

Ah! Jam bërë e tëra vjeshtë!

Në gjakun tim po rrjedh vetmia,
Që më mori me vete në kolapsin e fundjanarit 2008.
- Sa i madh e i bukur ishte Dielli ato ditë dimri plot acare!

Pse, bre, nuk e dita se do të vijë mesmarsi?!!

Dita e bashkimit pas ndarjes...!
Apo e ndarjes pas bashkimit...!?

Nuk dua të ma tregosh,
TI VETË E DI!

Përtej maleve Dielli ngroh ditën,
“Moi”, atë, kur unë Ty,
Po -
Përgjithmonë do të harroj!

TË KAM ZAMBAK TË GJAKOVËS

Kokën e kam shtrirë në qetësinë e natës,
Dua ëndërrën ta thërras në takim.

Që kur Ty të njoha,
Gjumin syri ma lagu
Me shiun e lotëve dhe ëndërra
Më ikë
Me tradhëtinë e ferrit
Në heshtje,
E pa zë - si Ti!

Përse nuk ke mëshirë?!
Përse s'më flet me gojë?!
- A e di se dashuria ime për Ty,
Është si trëndafili i Elbasanit,
Edhe unë Ty të kam Zambak të Gjakovës!

Jam betuar se në Pranverën e Virgjër,
Për Ty do të thur një kurorë,
Me lulet më të bukura të Kosovës,
- Ty, Diadem i Mbretërisë të dashurisë sime,
Të madhe e pa kufi –
E do t'ia fal PUHISË SË SAJ!

ME TY

Mbrëmë unë e Ti
- Ti Zhulietë
E unë Edgar Alen Poe!
Mbrëmë,
Më vonë se mbrëmja
- Unë Zhulietë
E Ti Edgar Alen Poe.

Mbrëmë që nga mesnata,
Ti me mua legjendë e Zhivagos,
Legjendë nëntori 2007,
Mbrëmë,
Ti kotja ime në pakthim!

Mbrëmë fjeta me Hënën

Mes kristalesh drite,
Humbavdekje,
Shtatë ditë e shtatë netë,
Gjuhën ma thau,
Ma vodhi fjalën foshnjare,
Të parën,
Ma vodhi fjalën foshnjare,
Të dytën.

Mbrëmë u treta në thirrje,
Një milion herë,
E mbeta si përherë e vetmuar.
Me minutat e pritjes kot -
Në minutat e pritjes.

TI, HESHTJA IME MEMECE

Mbrëmëm,

Edhe sot,

E, edhe nesër,

Edhe,

Edhe,

Edhe...

Tërhiqe zvarrë kullimin e lotëve,

Në shpirtin që e regj zemrën.

Për heshtjen varr -

Për humbjen e fjalës time

Foshnjare të parë -

Për humbjen e fjalës time,

Foshnjare të dytë!

E sot,

Sot,

Me Ty'

E'

Pa Ty,

Ndaj mërzinë,

Që as ti vetë nuk e beson,

Me lotin tim skëterrë,

Që nga thellësia e shpirtit,

Si gjak më kullon...!

Me Ty dua vetëm një herë të flas,

Mbase zërin ta dëgjoj,

Atëherë zemra të më pëlcasë.

E në çastin shterp,

Që rrezen e dritës e shkatërron,

Irisi i humbur sterrë,
Vdekjen të ma lehtësojë.

MBET E DREJTË - PA MBURRJE

Nuk të dua anipse nga larg,
Ti një trëndafil do të ishe,
Nga krypa e Tpasit,
Ose shigjeta e Neptunit,
Që flakën e shpërndan.

Të dua,
Ashtu si njeriu ca gjëra të errëta
I dashuron.
Dhe atë në shkëlqimin e verbër
Të zemrës së copëtuar
“Më shumë se dje e më pak se nesër”!

Të dua pa e ditur përse?!
Qysh kur e prej ku?!
Të dua me të drejtë pa kompleksitet e mburrje!
Të dua sepse ndryshe nuk di
Aq shumë sa që:
- Dora jote mbi toraksin tim -
Dora ime është,
Aq shumë sa që kur Ti sytë i mbyll,
Mua shumë shpejt gjumi më zë...!

EDHE PËR KËNGË

Sot ma kënaqe zemrën,
Ma mbushe shtëpinë,
Me zërin tënd të bukur,
Me shpirtin plot dritë,
Me dashurinë...

Krahët m'i dhurove,
Shpirtin, gëzimin...
Ecjen ma shpejtove,
Ma fale fluturimin.

Mos, të lutem, mos,
Se më lëndove fort,
Me le duke qarë,
E s'po pushoj dot.

Në zemrën time,
Loçkë,
Aty thellë ke hy.
Po më lëviz me gjakun
Të kam shpirt unë Ty.

MË PRIT...

P rit

O se

E ja ti

Z emra

I me - shpirt

D ua

A nipse

S i e

H utuar

U lëras

R rugëve të

I kjes bashkë me vetminë - **VETËM**

E dhe

GËZUAR DITËLINDJEN

Si (n)' Qersh-i (or) - iku e kuqe flakë,
Rrezja e Diellit në thellësinë e mbrëmjes,
Puthi natën,
Dhe mori dashurinë gaforre në katrore,
Për 24 orë ose 45 herë në gji!
Me qejfe të thashë: (n)' Korri (ik) or,
Shtatë kalinjtë e heshtjes,
Me të hidhet se vetë vdekja shekullore.
E nëse do, thuri shtatëmbëdhjetë Poezi për Breqet,
Sepse molla qe ngrënë.
Ty, zemra ime 1 (Perisht) Marathonomak,
Vetëm e vetëm për mua,
Gushën ta puthi si pëllumb.

EDHE NGA LARG

Rrezja e Diellit puthi Yllin e Mëngjesit,
Akullit ia fali lagështinë e lotëve,
E vuajtjes së takimit në largësi,
Dashuria frymën ia zuri...!

MOLLA QË HËNGRE

Mollën që e hëngre,
Ishte e kuqe.

E kafshove,
E hodhe,
Në shportën e mbeturinave...

Mbase gabove,
Farërat i kishte origjinale,
Si të atyre,
Nga Naissi...

Mirë nuk bëre,
Hiq,
Që e kafshove,
Dhe u ndave,
Duke e lënë të lënduar...

ATENTAT

Dielli nuk duron t'i bëhet atentat,
Qelizat nuk durojnë të gënjehen...
Bashkimi nuk duron për respekt ndarjen,
Hëna nuk duron t'i vjedhin syzet...
Ajo nuk është e verbër,
Ajo sheh me sytë e shpirtit...

MË KE TRADHËTUAR

Më ke tradhëtuar në emër të shkrimit,
Në emër të figurave më ke tradhëtuar...

Kurrë nuk do të zërë vend,
Fjala e jote poetike...

Pena jote nuk ka për të shkruar më poezi,
Stuhitë e lakmisë e të tradhëtisë,
E kanë fundosur në thellësi të oqeanit...

Do të të mallkojë fjala e shkruar,
Edhe figurat e saj përjetë...

BUKURIA E DITËS

Hëna u përshëndet me terrin e natës,
Dhe Diellit ia fali dashurinë,
Për t'ia shtuar hijershinë,
Bukurinë e madhështinë e ditës.

Sot kur malli si kurrë më parë,
Shpirtin ma ka kapluar,
Nga foleja e gjoksit tënd,
Kosova ime,
E puthi çdo ditë të re.

HËNËS I TREGOJ

Dielli,
Shkatërroi një grumbull të reve
Të zeza skëterrë
Dhe qiti syrin e tij.

Ma fali mëngjesin,
Lotin ma teri në strehë,
Që shiu të mos ma lagë qerpikun...

Edhe Hënës do t'i tregojë,
Se sa mu bë zemra mal.

DESHA TË SHKRUAJ POEZI

Desha të shkruaj një poezi,
Desha të t'i them vetëm dy fjalë,
Desha të jem pranë teje -
Aty përbri...
Në mos mundsha në faqe,
Të të puth në ballë...

BUZË RRUGËS

Buzë rrugës së pakthim,
Thitha pikën e vesës së mëngjesit.
Dhe e gjora nuk e dita,
Se lagështia e pabesë,
Shpirtin ma thau...

Tradhëtia ishe Ti,
Randevouz nuk bëhet me Luciferin!

Pakthimi s'ka kthim
Në pakthim...!

VDEKJEN S'TA KAM BORXH

Mos u fsheh pas Diellit kot,
Sepse të sheh Hëna.

Pas Hënës s'mund të fshihesh,
Sepse të shoh unë me Yjet.

Gjithësesi s'është vetëm e jotja,
Ajo do gjithnjë lindje të reja.

Vdekjen nuk ta kam borxh,
Mbase këtë e ke kuptuar...

NË ZEMËR TË KAM

Në zemër të kam,
Edhe në shpirt...
Thellë.

Diellin në Ty e putha,
Drejtëpërdrejt pa lajka.
Pa rroba kllounësh,
Pa lëkurë të humbjes së virgjër.

Vetëm Ty të kam,
Edhe në zemër,
Edhe në shpirt...
Thellë...

MASHTRIMET E NARCISIT

Në lagështinë e e vetëgjelbërimit,
Lotueset i hetojnë mashtrimet e Narcisit.

Mëkat për bukurinë që humbet pas kolapsit,
Për hyrjen e vetvetes në qejfe,
Mbi beben e syrit shterp...

Mëkat për nënën,
Mëkat për babanë,
Që gëzimet e klithjes së parë foshnjore
Ia falin djalit.

Grimcat e pasqyrës të mbledhura grumbull,
Reflekse portretesh për bukurinë thurin -
Ata kanë vetëm tri ditë jetë...

Kështu thanë të parët!!!

KRENARIA E KUKËSIT

Më lejove Diellin ta puthi shqip!

Për herë të parë,

Shpirtërisht,

Ia theve qafën mallit.

E hodhe për një çast në greminë.

Edhe kurbetit skeletin ia thërmovë!

Me krenarinë e bujarinë Tënde,

Për mallin e shpëtimit tim.

HËNA S'ËSHTË JETIME

Zëri i bilbilit më ngazëllen,
Kur këndon këngën e tij,
Mendjen time ma rrëmben.

Për kurbet kurrë s'do të këndoј,
S'do të këndoј shumë as edhe pak.
S'do të thuri vargje e poezi,
Se nga syri do të më rrjedhë gjak.

Ah,
Tash nëna në terr vajton,
Edhe pse Dielli si këtu ndriqon.
Natën,
Pse Hëna rri në mendime?
Pse ka ngelë vetëm,
E duket si jetime!?

Dhe ia zgjas dorën Hënës,
E me zemër thërras.
Nga malli shkrumbi i nënës,
Oooo! -
Zemra,
Bre,
Zemra le t'më pëlcasë!

KURORË PRANVERE

Edhe kësaj Pranvere,
Ia kishin grisur fustanin...
Kishin dashtë t'i shturin kurorën,
I kishin pasë thënë të vijë vetëm -
Por ajo prapëseprapë,
Si përherë erdhi,
Bashkë me shqiponjën!

II

UNË E TI NJË RELAKS

Poemë

I

Mashtrimit ia vura nënkëmbëzën,

Për ta shpëtuar harresën,

Se ti u zure me tre,

Për qëllimin,

Për trishtimin...

Që të largohesh e të thuash:

- Jo unë s'pata faj!

Sherri të zuri për krahu,

Bashkë me hijen ndjekapase.

Theu qafën sakaq si ora,

Që përcjell kohën me trishtim.

- Po, po! Ti pate faj,

Sherr - ti hija jote ndjekapase...!

II

Në mua gjej udhëtimin,

Me mendimin e bartjes,

Ego në rrugën e pafaljes,

Mike e dashuruar?!

- Pse nuk del nga vetvetja?!

Me dashuri, me miqësi,

Që në mua ta gjej prapë,

Udhëtimin me mendimin e bartjes së Egos,

Zvarrë...!

III

Unë e di,
Se Ti më sheh!
Pa frikë -
Pa urrejtje...
Numëroj minutat në kotje,
Si hije e trajtuar,
E njeriut me kohë të mjaftueshme...!

IV

Një mori damarë akujsh,
Fundosen pa shpresë,
Në verën e kaluar-skllotë,
Në thellësinë e syve të Tu...
Çfarë tradhëtie!!
Nëntori i kaluar,
Prej detit të gjerë në oqean,
Ku loti përplaset me dhimbje,
Te ti,
Zotërotja ime...!

V

Çdo gjë që bëra,
Ishte me kast.
Çdo kast që vura,
Ishte një rast.
Pahirin e trazova,
Të iki nga rruga ime,
Pa përftyrime,
Syrgjyn gjallë,

Ti,
Vetmia ime...

VI

Shkoi,
Po,
Po,
Shkoi...
Me frymën pa ndryshim,
Në mall të pasosur,
E shtërngimin tënd,
Shtrydhje.
Fus në duart,
Që bashkë me mua,
Shkon,
Po,
Po,
Shkon...
E më kurrë nuk vjen!
Dashuri është aroma jote,
Është aroma ime,
Kur era më shtrydhë,
Dua e s' dua unë!
E me tretjen tënde,
Mbi supet e mia,
Me Diellin,
Prapë se prapë,
Do të jem si me Ty...

VII

Në vendin ku uleshim,

Nuk ulem dot.
Në hotelin e pritjes,
Fluturim e krahëkëputur,
Pres shkuarjen me Ty -
Pa Ty të nisem -
Me Ty,
Pres kohën,
Si një herë që shkoi...!

VIII

Unë edhe ti,
Më duket me qeshim njësoj!
Ti edhe qan si unë!
Ti,
Fatkeqësia ime...
Ti,
Thithja e ajrit në mushkëritë,
Ngazëllim që ma ka ënda,
Edhe kur nuk ndihem e uritur.
Te Ti që shuhesh,
Në lagështirë vese,
Buza e mëngjesit,
Ylli im i parë...!

IX

Nuk dua t'i dalloj njerëzit,
Nga hija me parametër
Neuronesh -
Për ndërrimin
Sikur mëngjesi mbrëmjes
Buzëqeshjen ia falë!

Shikimin e mikut
Ti
Shoqe...!
Nuk e mora nga ti
Përfytyrimin e formës së njejtë
Në konture tiparesh,
Si të gjithë në një mënyrë,
- Trishtimit portën.
Nuk ia hapi dot,
Lodhjen e sodis,
Në qerpikun e gjysëmlëshuar,
Më dukesh shumë i vogël,
Ti ani i madh
Sa qudi!?
Nuk dua të të shoh gjysëm...!

X

Ka njëzet e shtatë vjet,
E më shumë...
Kisha krahë,
Kisha gëzim.
- Përse nënë, vajin ma dhurove?
- Nuk dua të qaj,
- Nuk dua të qesh,
Kur vetëm Ti do!
Bebëzën e syrit ta fala,
Ti,
Drita ime,
Edhe në natën pa Hënë,
Ti,
Rrezja ime,

Diell!
Ti,
Shkëlqimi im SUPERNOVE...!

XI

Ti ecë me mua,
Të bart si hijen time.
QUDI!
Të bart rëndë...
Me QUDINË!
Jo gjithnjë me mua
QUDITEM edhe vetë,
PSE?!

XII

Tradhëtinë në mua,
Kot e ke ta gjesh.
Bashkëshortin,
Shumëherë,
E zgjova nga kllapimi...
Shko - ik!
E në fund!
Ikja isha vetë!
Vetë krenaria ime,
Unikat në ndarje,
Si pranvera pink...!

XIII

Me tiparet e mia,
Të bukurisë së thjeshtë,
Puthi artin e natyrës,

Pa konture.
Lodhjen në kohë,
Rrudhë e dashjes pa dashje,
Vitet nuk i ndjej në shpinë...
Bartje,
Lavdëruar qoftë arti i shpirtit Zot,
O Zot i madh,
Ti,
Mbështetja ime,
E para,
E fundit,
Me ndërgjegjen zemërplot...
Sa shumë të falem Ty,
Që mua ndoshta si dhuratë
Më solle!

XIV

Kur të thuash se të dua,
Për inat,
Nuk u desh të ikësh.
Bashkë me ëndërrën,
Gjumin çdo mbrëmje e thërras,
Me qerpikun tënd të mbyllur,
Dhe saora fjetja ime
Shekullore
Me humbjen e kristaleve,
Pasqyrë përftyrimesh,
Me mijëra halle...
Quditërisht,
Mori ëndrrash shqelmohen,
Nga zemra e coptuar...

XV

Lagështirë,
Ujë,
Qullë...
Ndjeva në mua.
Dikush më tha:
- Ishte shkëlqimi
Pa shushurimë,
Ishte e jona
Kënaqësi në amshim.
E unë -
Unë u largova,
Ani që Ti atë ditë,
Nuk deshe.
Mos harro!
Fe - ani 1 është vetëm imi
Si Marathonomaku...!

XVI

Dyshemesë në shtëpinë e madhe,
Të shkronjave të bashkuara,
Inatin ia hoqëm...
Plot shprazje -
Pa gjënim...
Me dridhje,
Plot gëzim...
Dritë aty,
Dritë këtu,
Portë e mbyllur me çelës.
Çelës...

Hekur anë e mbanë,
Ani - de,
Mirë, - thashë,
Ti dashuria ime,
E imja e madhe,
Dhuratën ndarje
Ta futa në pakon e pakthimit...!

XII

Jeshil nuk pikturoj,
Qudi,
Shumë herë nuk dua,
Ngjyrë kafeje,
Po, po...
Do të gjesh në mua.
Jo,
Në shpirt,
Jo,
Aty gjithmonë jeshil,
Po në sytë që nuk i do.
Ata që s'janë tebdil,
Më tha se makiaton,
Ty ta ka ënda.
Hyr në sytë e mi,
E mbete në zemër brenda...

XIII

Sihariq krahërori im,
Tradhtia dështoi...
Gjiri im,
Gjoks plot Nënë e birit.

Vetëm për të
Gëzoj...
Sihariq,
Krahërori im,
Sihariq,
Sihariq...
Ngrohtësi e ngjeshur
Në mua
Sa e lumtur u bëra sot...

XIX

Rrugës së shkuarjes
Vij prapë,
Shkoi anash
Në vëmendje,
Se dorën nën ngricën
Lypje
Se lëndoi dot...
Zemër,
Mbaje lotin!
Unë e ti jemi syshkruar,
Si kafeja
Buzë liqenit të kaltër...!

XX

Mos më prit në heshtje
Me muaj
Se pranvera gati erdhi,
Në trupin e ledhatimin tim.
Lëvizje të tjera nuk dua të ndjej.
E rrethuar në pritje,

Një vit e më shumë,
Pres pranverën
Të më marrë me vete.
Bashkë
Ikjen time -
TI,
Ikjen tënde -
MUA,
Unë e Ti gjithmonë
Ikje në pakthim...

XXI

Pesëdhjetë-a janë shumë?
- Jo, - tha dashuria.
- Jo, - the Ti!
- Po, - thashë unë.
- Ehhhhh?!!
Gjysëmfillimi në mbarim.
Gjysëmbarimi në fillim.
Ehhhhh?!! - për mua.
Ehhhhh?!! - për Ty!

XXII

Ti nuk e gjete fillimin,
Në oshëtimën pas heshtjes.
Ti nuk ndjeve oshëtimë...
Ehoo - je si në mal!
Krenaria ma shtoi
Bukurinë.
Oshëtima ime,
Vërtetë

Ti kala e shembur,
Vese plot e përplot,
Lagështi - qullë në mua...

XXIII

Në rrugën gri të Vjeshtës,
Nga trishtimi
Gjethet e blirit heshtin...
Nën shkeljen e kalimtarëve,
Shkofshin në pakthim...
Ata që i prekin sensorët,
E dhembjes gjer në palcë!

XXIV

Më mos më prit
Të trokasësh në portën e dashurisë.
Nuk dua të dëgjoj...
Jo,
Jooo!
Kam hedhur peliçen
Përmbi zgavrra të veshëve,
Zhveshjeve nuk ua shtoi bukurinë...
Mos më prit me ngricat,
Kristale flluskash
Në liqenin e dashurisë sonë.
Ngricë,
Se unë vetëm me Diellin,
Do të bëj Rendezvous-mon Seniore...!

XXV

Unë nuk kam halle,

E nuk digjem.
Se s'kam zjarr
Në veten time...
Me Ty dua
Djersën e zhegës dashuri ta fshij
Djersë vullkani
Në Ty
Djersë vullkani
Në mua.
Unë e ti
Shpërthim pa kontrolle,
Llavë flakë e kuqe
Ooo, bre! -
Si vetë gjaku...!

XXVI

Në mbrëmje,
Unë jam unë
Në origjinal,
Si tërë dita vetë.
Në mbrëmje
Pse,
Pse ta thërras bukurinë!?
Me lapsin
Si vetë nusëria e moçme,
Në kutinë e vjetër
Mbuluar me merimanga,
Me të kuq buzësh
Kur buzët
Kështuashtu
Si qershi

E si Molla e Kuqe i kam!
Deri edhe pas mbrëmjes
Kuq unë,
E,
Kuq Qielli
Nga perëndimi.
Aty ku me mua
Bie në gjumë Dielli.
Unë kuq nga Ti
E ti kuq ndoshta
Nga marrja e heshtja,
Që as vetë nuk e di
Përse!?
E unë po -
Po e di...!

III

NË THELLËSINË E NDJENJAVE

Në thellësinë e ndjenjave,
Të kam,
Ty,
Kosovë,
Të kam,
Ty,
Gjakovë...

Aty ku nëna më dha gji,
Mallin kujtoj...

Kjo largësi më ka tretur
Diku thellë,
Në mallin e Shpirtit tim,
Për Ty
Kosovë.
Në mallin e Zemrës time
Për Ty
Gjakovë...

Rrugës së mërgimit,
Larg Vendlindjes,
Larg Gëzimit,
Thurë me kurorën e vetmisë...!